

Prela kërkon shtyrjen e seancës për 14 ditë në KPA

Nga [Exit News](#) 27-07-2020 në 10:28



Prokurorja Donika Prela kërkoji shtyrjen e seancës në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit (KPA) për arsye shëndetësore. Ajo paraqiti një raport shëndetësor ku thuhet se nuk mund të paraqitet në seancë për 14 ditë.

Prokurorja ka kërkuar më herët përjashtimin e Ina Ramës dhe Natasha Mulajt nga trupa që po e gjykon në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pasi mund ta paragjykojnë Prelën gjatë gjykimit. Ndërsa të

premtën, nga trupa gjykuese u largua gjyqtari Luan Daci, dhe u zëvendësua me Rezarta Schuetz.

Prela u konfirmua në detyrë nga shkalla e parë e vetingut, në një nga vendimet më të debatueshme të KPK-së.

Në prill 2019, Komisioneri Publik, Florian Ballhysa i kërkoi Kolegjit të Posaçëm të Apelit shkarkimin e saj. Sipas apelit, Prela nuk arrin nivel të besueshëm kryesisht në kriterin e pasurisë.